

Nr.03/KA/2023
07.04.2023

Në bazë të Rregullores për Punën e Komisionit të Ankesave të FVK-së, Vendimit të Komisionit Disiplinor, datë 10.03.2023, si dhe në bazë të Ankesës së KV Peja, datë 24.03.2023 (sipas protokollit zyrtar të FVK-së), Komisioni i Ankesave të FVK-së, merr këtë

V E N D I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT Ankesa e KV Peja e datës 24.03.2023 si e BAZUAR;
- II. KTHEHET NË RISHQYRTIM pjesa e Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 10.03.2023 që ka të bëjë me arsyetimin e këtij Vendimi dhe përdorimin e bazës ligjore;
- III. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 10.03.2023 deri në nxjerrje të një akti tjetër për çështjen në fjalë.
- IV. DETYROHET Komisioni Disiplinor në zbatim të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh.

ARSYETIM

Me datë 27.03.2023, Komisioni i Ankesave, përmes postës elektronike, ka pranuar Ankesën e KV Peja të datës 24.03.2023 (tash e tutje “Ankesa”) e cila ka të bëjë me pakënaqësitë të kësaj të fundit me Vendimin Komisionit Disiplinor, të datës 10.03.2023, i cili ka të bëjë me dënimin lojtarëve Agron Nikqi, Leutrim Mujaj, dhe ndihmës – trajnerit Milot Bardhi.

Në këtë kuadër, Komisioni i Ankesave, ka mbajtur takim më datën 04.04.2023, respektivisht më datë 06.04.2023 dhe ka trajtuar Ankesën e KV Peja dhe dosjen e lëndës në përgjithësi. Në takime kanë qenë prezent: Fidan Hamiti, kryetar, Bardhyl Ibrahim, anëtar dhe Armend Fazliu anëtar.

Komisioni i ankesave, në përbërje të plotë, ka analizuar ankesën e KV Peja, ka krahasuar atë me faktet në dispozicion, ka krahasuar ato në mes veti dhe me bazën juridike mbi të cilat është artikuluar vendimi i Komisionit Disiplinor dhe konstatoi se:

Me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, respektivisht dënimeve të shqiptuar ndaj lojtarëve, respektivisht ndihmës – trajnerit të KV Peja, edhe pse Komisioni i Ankesave ka gjetur fakte në formë të provave shkresore për ndërmarrje të masave dhe shqiptim të gjobave dhe dënimeve nga Komisioni Disiplinor, ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk ka arritur që ato t’i arsyetoj me bazën juridike, respektivisht nuk ka artikuluar pjesën arsyetuese të aktit administrativ siç përcaktohet me normat në fuqi.

Në pjesën arsyetues të aktit të nxjerrë, Komisioni Disiplinor, në arsyetimin e tij përmend vetëm faktin se: “Gjatë marrjes së vendimeve si masë lehtësuese është marrë kërkim falja nga KV

Peja”, ndërsa asnjë detaj tjetër arsyetues i cili është obligativ dhe pjesë përbërëse e një aktit administrativ.

Ndër të tjera, Komisioni i Ankesave, ka gjetur se, nuk është qartësuar baza juridike për matjen dhe shqiptimin e masave disiplinore të aplikuara ndaj lojtarëve të KV Peja, gjë që ka ngjallur reagim të arsyeshëm tek ankuesi kur është fjala tek matja e dënimit konform shkeljeve të supozuara.


Andaj, në bazë të kësaj që u tha më lart, Komisioni i Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni i Ankesave:

Bardhyl Ibrahim, anëtar



Fidan Hamiti, kryetar



Aremnd Fazliu, anëtar



Këshillë juridike: Pala e pa kënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh në Ministrinë e Sportit dhe Komisionin e Arbitrazhit Sportiv.

Vendimi t’u dërgohet:

1. KV Peja,
2. Komisionit Disiplinor,
3. FVK-së,
4. Sekretarit të Përgjithshëm të FVK-së,
5. Arkivit të FVK-së dhe
6. Komisionit të Ankesave.